



SHËRBIMI I PROVËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMIT TË PROVËS
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 364 Prot
Tiranë, më 20/02/2024



QENDRA PËR ZHVILLIM
KOMUNITAR
"SOT PËR TË ARDHMEN"

Nr. - Prot
Tiranë, më 20/02/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR "SOT PËR TË ARDHMEN"

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit të Provës në Republikën e Shqipërisë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë me adresë Rruga "Jordan Misja", Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Klevis Qose**, në vijim e cilësuar si "DPSHP";

dhe

Qendrës për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen" organizatë e pavarur, jofitimprurëse dhe joqeveritare) e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë më nr vendimi 830, datë 02.10.2013, rifreskuar me vendim nr. 830/1, datë 04.04.2018, me adresë Rruga "Elbasanit" Pallati Abau, Ap. 11, Shk. 2, Tiranë me numrin tatimor L32221751H, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Zj. Fabiola Laco Egro**, në vijim cilësuar si "QZHK".

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të sigurojë një kornizë bashkëveprimi dhe të rregullojë dhe forcojë bashkëpunimin institucional midis Shërbimit të Provës dhe QZHK në kuadër të konsolidimit të qasjeve rehabilituese dhe reintegruese për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin (fëmija i dyshuar, i akuzuar, autor, i dënuar, viktimë ose dëshmitar i veprës penale), në zbatim të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur, duke përfituar nga zbatimi i aktiviteteve të Projektit në përputhje me qëllimin e përgjithshëm të tij dhe objektivat specifike të specifikuara në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshje.

Neni 2

Objekti

Objekt i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi dhe vendosja e ndërveprimit të përbashkët dhe ndërsjellët midis Palëve dhe përcaktimi i vazhdimësisë së këtij bashkëpunimi që nga periudha e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje deri në përfundimin e saj, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e ndërsjella në kuadër të konsolidimit të qasjeve të integruara për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin, i cili ka si qëllim kryesor përmirësimin e kapaciteteve që lidhen me rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve të dyshuar, të akuzuar, autorë, të dënuar, viktimë ose dëshmitarë të veprave penale. Shërbimi i Provës në Republikën e Shqipërisë dhe QZHK pranojnë rëndësinë e komunikimit aktiv, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet tyre për zbatimin e aktiviteteve të projektit në fjalë dhe iniciativave të përbashkëta, për të menaxhuar zbatimin e suksesshëm të projektit dhe arritjen e rezultateve dhe objektivave specifike të tij.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" në ligjin nr.7895, Ligjit Nr. 18/2017, datë 23.02.2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin 79/2020 "Për

Ekzekutimin e Vendimeve Penale", në ligjin nr. 78/2020 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Provës", në VKM nr. 421 datë 08.07.2021 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës".

Neni 4

Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

1. DPSHP bashkërendon punën koordinuese për të zbatuar aktivitetet e projektit përmes vendosjes së pikave të kontaktit në lidhje me menaxhimin e vendimeve alternative dhe masave të shmangies në përputhje me vendimin e prokurorisë/gjykatës, duke reflektuar nevojat dhe potencialet e fëmijës/familjes dhe të propozojë masat dhe/ose ndërhyrjet rehabilituese dhe riintegruese, në përputhje me ndryshimet në nevojat dhe rreziqet me të cilat përballlet fëmija në vazhdimësi.
2. Të bashkërendojë punën me QZHK-në, me qëllim që të sigurojë prej tyre mbështetjen e të miturit në përmbushjen e detyrimeve sipas masës dhe në kapërcimin e vështirësive në riintegrimin shoqëror, para, gjatë dhe pas përfundimit të periudhës së provës, ndër të tjera, në adresimin e problematikave të strehimit, punësimit, formimit të tij profesional, etj., me qëllim reduktimin e rrezikut të recidivizmit.
3. Koordinon me QZHK në realizimin dhe zhvillimin e mësimëve të nxjerra dhe praktikave të mira për zbatimin e planit aktual të veprimit dhe strategjive të tjera ndër sektorialë të përcaktuara në vendimet gjyqësore.
4. Bashkëpunon me QZHK në mirëbesim për të zbatuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit;
5. Siguron dhe zbatojë kushtet e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje;
6. Mbështet dhe ndërmjetëson kur është e nevojshme me përfaqësues të institucioneve të tjera për zbatimin me sukses të aktiviteteve të kësaj Marrëveshjeje;
7. Bashkëpunon dhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet që parashikon Marrëveshja si dhe të dakordësojë në lidhje me aspekte të caktuara të organizimit të tyre;
8. Cakton një person kontakti për komunikimin me QZHK, i/e cili do të angazhohet drejtpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
9. Mban kontakte të vazhdueshme me personin e kontaktit të caktuar nga QZHK lidhur me mbarëvajtjen e projektit.

Neni 5

Detyrimet e Institutit për Aktivizëm dhe Ndryshim Social

1. Mbështet DPSHP për mbarëvajtjen, efektivitetin dhe cilësinë e aktiviteteve sipas përcaktimeve në projekt;
2. Bashkërendon me DPSHP procesin koordinues dhe zbatues për përmbushjen objektivave të përmendura në programin e projektit;
3. Bashkëpunon me DPSHP në promovimin e ndryshimeve ligjore dhe administrative për qasjet dhe rolin e shumë agjencive të aktorëve të ndryshëm në proceset e rehabilitimit dhe riintegrimin të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin.
4. Bashkëpunon me DPSHP në mirëbesim për të zbatuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit;
5. Siguron dhe zbatojë kushtet e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje;
6. Cakton një person kontakti për komunikimin me DPSHP dhe institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e projektit, i/e cili do të angazhohet drejtpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit

Palët të mbështetura në parimet bazë, do të mbajnë të informuar njëri-tjetrin dhe do të konsultohen për çështje me interes të përbashkët, të cilat sipas mendimit të tyre ka të ngjarë të çojnë në bashkëpunim të ndërsjellët.

Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve sipas këtij neni do të jetë duke ruajtur karakterin konfidencial dhe të kufizuar të informacionit dhe dokumenteve të caktuara.

Palët në kohë të ndryshme sipas nevojës, do të kërkojnë për t'u mbledhur për të shqyrtuar dhe diskutuar mbarëvajtjen e aktiviteteve të zhvilluara sipas kësaj Marrëveshje dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.

Neni 7

Personat e kontaktit

Secila nga palët përcakton nga një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura. Në rast të zëvendësimit të personit të kontaktit palët njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën duke përcjellë informacionin përkatës. Të dhënat e personave të kontaktit parashikohen në Aneksin 2 bashkangjitur kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përcaktohet në bashkëpunim me Palët, si një marrëveshje pa afat por me hapësirë amendimi në rast të shtimit të objektivave të synuar apo në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9

Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, duke qenë partnerë në zbatimin e saj dhe duke punuar së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të parashikuara.

Takime periodike do të realizohen midis stafeve përgjegjëse dhe personave të kontaktit të DPSHP-së dhe QZHK në lidhje me ecurinë dhe arritjen e objektivave të projektit.

Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë Marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Neni 10

Përfundimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje detyron Palët të respektojnë qëllimet e përcaktuara në nenet e mësipërme sipas kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Secila nga palët mund të tërhiqet nga angazhimet e marra përsipër dhe të ndërpresë bashkëpunimin kur:

- a. Me pëlqimin e ndërsjellët,
- b. Me përmbylljen e programeve
- c. Me ndryshimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje;

d. Konstatohen shkelje të angazhimeve të marra përsipër;
Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit në rastet kur vendoset tërheqja përpara përfundimit të afatit të kohëzgjatjes.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor që mund të lindë mes Palëve, do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet Palëve, deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.

Neni 12

Dispozita të fundit

Palët lidhin këtë marrëveshje me qëllim respektimin e të gjitha dispozitave bazuar në parime të integritetit, pavarësisë dhe lirisë nga kritika e njëanshme për bashkëpunimin e Palëve gjatë periudhës së zbatimit të programit të projektit.

Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e ndonjërës prej Palëve për të punuar në mënyrë të pavarur me organizata/institucione të tjera, për të vënë në zbatim programet, projektet apo politikat e saj, sipas veprimtarisë së secilës Palë.


Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga të dyja Palët pas dhënies së pëlqimit reciprok.


Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje është ekzekutuar në katër (4) kopje origjinale; çdo Palë mban 1 (një) origjinal dhe një dublikatë. Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy Palët.

PALËT NËNSHKRUESE:


Klev DROSE
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës




Fabiola LACOLERO
Drejtor Ekzekutiv
QZHK "Sot për të Ardhmen"



ANEKS 1 – PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Titulli i Projektit	<ul style="list-style-type: none">• “Mbështetje për funksionimin e rrjetit lokal ndër-institucional, koordinimin efektiv dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin” Shkodër (Vau i Dejës, Fushë Arrëz, Pukë) dhe Lezhë (Shëngjin)
Qëllimi kryesor i Projektit	<ul style="list-style-type: none">• Të kontribuojë në mundësimin e një përgjigjeje ndër-institucionale të koordinuar për mbrojtjen, parandalimin, ri-integrimin dhe rehabilitimin me bazë komunitare të fëmijëve të përfshirë në procese penale si autorë viktime e dëshmitarë apo atyre në rrezik për t’u përfshirë apo prekur nga veprat penale.
Objektivat specifikë	<ul style="list-style-type: none">• Mbështetje dhe rritje e kapaciteteve të grupeve ndërsektoriale të profesionistëve në nivel vendor dhe mbështetja e tyre në zbatimin e një qasjeje shumë disiplinore në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt dhe kontakt me ligjin, duke përfshirë dhe rastet e fëmijëve në rrezik trafikimi.
Përfituesit	<ul style="list-style-type: none">• Mbështetja e fëmijëve në konflikt dhe kontakt me ligjin, përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme ndërdisiplinore të integruara, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për respektimin e të drejtave të tyre.• Përfituesit kryesorë të projektit përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë në konflikt/kontakt me ligjin, mësuesit, profesionistët e sistemit të drejtësisë, si gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë dhe profesionistë të tjerë të ndryshëm, dhe prindërit/familjarët e fëmijëve. Këta përfitues do të fitojnë njohuri dhe shërbime mbështetëse në fusha të tilla si drejtësia për të miturit, praktikat restauruese, zgjidhja e konflikteve, aftësitë e sjelljes konstruktive, këshillimi për karrierë, ndërmjetësimi dhe teknikat e prindërimit pozitiv, duke synuar përfundimisht të përmirësojnë mirëqenien dhe rezultatet e të miturve të përfshirë në drejtësi. sistemit dhe familjeve të tyre.• Sesione trajnimi për aktorët lokalë në fushën e legjislacionit, politikave, dhe praktikave të drejtësisë miqësore për të mitur, duke u përqendruar, ndër të tjera, tek shmangia e të miturve nga proceset penale, zbatimi i masave alternative ndaj dënimit me burgim, drejtësinë restauruese, ndërmjetësimin, mbrojtjen e fëmijëve nga rreziku i trafikimit dhe barazia gjinore.• Tryeza vendore për institucionalizimin dhe forcimin e mekanizmit ndër-institucional vendor të referimit dhe menaxhimit të rastit përmes qasjes shumë disiplinore, duke ofruar mbështetje dhe për grupin ndërdisiplinor për identifikimin, referimin dhe trajnimin e rasteve të të miturve në kontakt dhe konflikt me ligjin.
Plani i Aktiviteteve	<ul style="list-style-type: none">• Mbështetje për menaxhimin e rastit dhe ofrimin e integruar të shërbimeve për fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin, bazuar në një qasje shumë-sektoriale dhe ndër-institucionale, duke përfshirë këshillim psikologjik, ndihmë ligjore, shërbimndërmjetësimi, praktika restauruese, si dhe shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave të çdo rasti.• Përshtatja e praktikave të menaxhimit të rastit për të siguruar rehabilitimin dhe ri-integrimin me bazë komunitare përmes hartimit, mentorimit dhe zbatimit të planeve individuale të ri-integrimit me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin dhe familjeve e tyre, si dhe përmes referimit të këtyre rasteve në shërbime ekzistuese, të ofruara nga institucionet shtetërore ose OJF-të vendore.

Rezultatet e pritshme

- Aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuese mbi parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve në shkolla.
- Sesione informuese dhe ndërgjegjësuese për prindër dhe fëmijë mbi qasjet e reja në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe të drejtat e fëmijëve në procesin e drejtësisë penale.
- Aktivitete ndërgjegjësuese edukative dhe argëtuese me fëmijët me tematika të lidhura e drejtësinë penale dhe qasjen e barabartë të fëmijëve në drejtësi.
- Fushatë mediatike për të promovuar në publikun e gjerë qasjet e reja në Kodin të Drejtësisë Penale për Fëmijët dhe përpjekjet e institucioneve në Pukë dhe Shkodër për vënien e tij në jetë.
- Program prindërimi për disiplinimin pozitiv, për nxitjen e koncepteve të barazisë gjinore dhe për udhëheqjen e fëmijëve drejt një jete larg prej rreziqeve të krimit.
- Përshtatja e praktikës së koordinimit vendor për drejtësinë për të mitur në Shkodër, Pukë dhe Lezhë,
- Mundësimi i një përgjigjeje ndërinstucionale të koordinuar për mbrojtjen, parandalimin, ri-integrimin dhe rehabilitimin me bazë komunitare të fëmijëve të përfshirë në procese penale si autorë viktime e dëshmitarë apo atyre në rrezik për t'u përfshirë apo prekur nga veprat penale.